



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA DURRES

Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 22 23 10 e-mail: info@durres.gov.al

Nr 2292 Prot

Durrës më, 04/09 /2016

KONTRATË PËR SHERBIME KONSULENCE

**“Studim projektim “Projekt zbatimi i sheshit publik  
para hyrjes se Portit””**

Nr. References se Kontrates: BD.SH.K.41.15

Lidhur ndërmjet palëve

**Bashkise Durrës “Autoriteti Kontraktor”**

Dhe

**ERALD- G + ARKONSTUDIO “Kontraktuesi”**

Bashkia Durres

1

ERALD- G + ARKONSTUDIO

## KONTRATË

“Studim projektim “Projekt zbatimi i sheshit publik para hyrjes se Portit””  
Nr i referencës BD.SH.K.41.15

Kjo marrëveshje (Kontratë) nënshkruhet sot më datë 04 . 04 . 2016, Durrës ndërmjet dy palëve:

“Autoriteti Kontraktor”     **Bashkia Durrës**  
Adresa :                     Sheshi “Iliria”, Qyteti Durrës  
Tel /fax:                    052 22 23 10  
NIPT :                        K42006501R  
Përfaqësuar nga Kryetari Bashkise z. Vangjush **DAKO**

*Dhe*

“Kontraktuesi”     **ERALD- G + ARKONSTUDIO**  
Adresa :                     Diber Maqellare HERBEL, Zyra ne katin e pare, banesa 2-kateshe ne  
                                  lindje te fshatit herbel, Komuna Maqellare;  
Tel /Fax:                    0682090392  
NIPT :                        K36306784K + L42019004I  
Përfaqësuar nga Administratoret z. **Gezim ISLAMI** dhe z. **Krenar DILA**

### Neni 1 - Baza ligjore

Kontrata mbështetet në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit, Ligji nr. 139/2015 “PER VETEQEVERISJEN VENDORE, Vendimin nr. 704, date 29.10.2014 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM”, dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 2- Përbërja e kontratës

2.1 Kontrata do të përbëhet nga dokumentet e mëposhtëme dhe dokumentat të tjera të tenderit te dates 21.01.2016 , duke përfshirë KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit si dhe aneks kontrata per termat e references, metodologjia e paraqitur nga Kontraktuesi.

- Sigurimi i kontratës në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e garancisë lëshuar nga shoqëri sigurimi.
- Oferta sipas detyres se projektimit ne dokumentat e tenderit me propozimin teknike dhe ekonomike te paraqitur nga Kontraktuesi ne tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor .

2.2 Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës ne dokumentat e tenderit.

### Neni 3 – Objekti i kontratës

- 3.1 Objekti i kesaj kontrate eshte sherbimi per realizimin e projekt zbatimit te plote per objektin :  
“Studim projektim “Projekt zbatimi i sheshit publik para hyrjes se Portit””

### Neni 4 – Çmimi i kontratës

- 4.1 Çmimi që i paguhet kontraktuesit për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të kontratës është Vlera 24’890’000 leke (njëzet e katër milion e teteqind e nentëdhjet mijë) leke pa tvsh dhe me tvsh 29’868’000 (njëzet e nente milion e teteqind e gjashtëdhjet e tete mijë) lekë
- 4.2 Çmimi përfshin te gjitha detyrimet fiskale qe parashikon legjislacioni shqiptar.

### Neni 5 – Afatet e Pagesës

- 5.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 5.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 5.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t’i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 5.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 5.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

### Neni 6– Afati i dorezimit te projektit

- 6.1 Projekti i zbatimit do te dorezohet nga shoqeria projektuese ne afat kohor prej 30 (tridhjet) ditesh kalendarike nga dita e lidhjes se kontratës sipas kërkesave te kerkuara ne detyren e projektimit(aneks kontrate).
- 6.2 Projekti do te merret ne dorezim nga perfaqesues te Bashkise Dures , te cilet do te verifikojne ate dhe do te leshojne aktin e marrjes ne dorezim te projektit.

### Neni 7– Vonesa ne zbatim dhe zgjatja e afatit .

- 7.1 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të

Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

### Neni 8 – Likuidimi i demeve

8.1 Tarifa ditore për demet e likujdueshme për kryerjen e Shërbimeve përtej afatit 30 ditor do të jetë 4/1000 e vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 përqind e vlerës së kontratës.

### Neni 9– Te drejtat dhe detyrat e Kontraktuesit

- 9.1 Kontraktuesi do të hartojë projekt zbatimin dhe do të dorëzohet Autoritetit Kontraktor si parashikohet në kushtet e kësaj kontrate.
- 9.2 Kontraktuesi është i detyruar të marrë në konsideratë dhe të pasqyrojë në projektin e zbatimit të objektit të gjitha vërejtjet që mund të lihen nga organet kompetente në lidhje me projektin dhe preventivin.
- 9.3 Kontraktuesi nuk ka të drejtë të japë projektin për përdorim apo shitje personave të tretë pa marrë miratimin e Autoritetit Kontraktor, i cili ka të drejtën e pronësisë mbi projektin e hartuar nga Kontraktuesi.
- 9.4 Kontraktuesi ka të drejtë t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues pagesën për projektin e hartuar prej tij në përputhje me nenin 5 të kësaj kontrate.

### Neni 10 – Pronesia e projektit

10.1 Çdo gjë e dhënë ose e paguar për projektin nga Autoriteti Kontraktues, si dhe vete projekti do të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues (Bashkia Durrës) si e tillë do të konsiderohen kudo që do të përdoren ato.

### Neni 11– Zgjidhja e kontratës

- 11.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse :
- Kontraktori dështon në kryerjen e shërbimit brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
  - Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj kontrate.
- 11.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japë Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.
- 11.3 Të gjitha materialet, e perfunduara do të behen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.

### Neni 12 – Sigurimi i kontratës

- 12.1 Shuma e sigurimit të kontratës prej 10 % të vlerës së kontratës do ti paguhet Autoritetit Kontraktor si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 12.2 Sigurimi i kontratës do ti kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së dorezimit dhe pranimit të projektit nga Autoriteti Kontraktor.

### Neni 13- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 13.1 Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura në lidhje me këtë kontratë me mirëkuptim dhe negociata midis tyre.
- 13.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do ti drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës dhe problemet do të zgjidhen sipas procedurave juridike në fuqi dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 14- Dispozita të fundit

- 14.1 Palet merren vesh midis tyre vetem me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.
- 14.2 Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dy palëve në gjashtë kopje, 1 (një) për Kontraktuesin dhe 5 (pese) për Autoritetin Kontraktor.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Autoriteti Kontraktor  
Bashkia Durrës

Emri dhe firma e Përfaqësuesit  
Vangjush DAKO  
Kryetar i Bashkisë

Vula:




Kontraktuesi  
ERALD- G + ARKONSTUDIO

Emri dhe firma e Përfaqësuesve

ERALD- G  
Gezim ISLAMI

ARKONSTUDIO  
Krenar DILA

Administrator te shoqërive  
Vulat:



## ANEKS- KONTRATE

“Studim projektim “Projekt zbatimi i sheshit publik para hyrjes se Portit””

Nr. References se Kontrates: BD.SH.K.41.15

DETYRE PROJEKTIMI

PER HARTIMIN E PROJEKTIT PER:

STUDIM PROJEKTIM: “ PROJEKT ZBATIMI I SHESHIT PUBLIK PARA HYRJES SE PORTIT

---

### TERMAT E REFERENCES

#### TREGUESIT

1. Objekti i ndërhyrjes.
2. Te behet zgjidhja e nyjes se rrjetit rrugor me nen kalim, midis rruges “Anastas Durrsaku”, Rruga “Egnatia”,Rruga “Taulantia” dhe “Bulevardi Epidamn”
3. Rishikimi i fasadave ne sheshin perpara hyrjes nr.1 te portit Durres.
4. Fazat e punes dhe lista e dokumentacionit per tu paraqitur,per secilin sherbim te kerkuar.
5. Lista e projekteve qe duhen paraqitur.
6. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e shërbimeve që kërkohen:

#### HYRJE E PËRGJITHSHME

##### 1. OBJEKTI I NDERHYRJES

Sistemimi i shesheve të reja të Qytetit të Durrësit është pjesë e një sistemi më të gjerë të transformimit urban të planifikuar në vitet e fundit për hapësirën publike, si vijën bregdetare dhe zonat e portuale.

Ndryshime të mëdha janë sjellë në qytet këto 20 vitet e fundit. Proçesi i rizhvillimit nuk ka nevojë për ndërtime të reja, por ka nevojë të përmirësojë dhe krijojë sisteme të reja shërbimesh, të trupëzuara këto, në një sistem infrastrukturash të përshtatshme.

Qytetit historik, i organizuar në pika qendrore dhe kryqëzime, i nevojitet një sistem përmirësimi sistematik, i aftë qe të përçojë ndryshime pozitive nëpër qytet. Kjo është gati e njëjtë me “agopunturën”, që funksionon duke përhapur shëndet ose përmirësuar funksionet në pjesë të ndryshme të trupit. Në rastin tonë duke pasur si qellim ri-zhvillimin,kjo metode mund të veprojë në pika të veçanta të qytetit duke sjelle një proces pozitiv zhvillimi.

Sheshi “Liria”, është pjesa e parë e puzzle-it në këtë projekt, si dhe shembulli i një rrethi vicioz në të cilin ne mund të perhapemi gjithnjë e më shumë në plane/projekte funksionale ne mbare qytetin.


Çdo zonë e re e përcaktuar në projekt duhet konceptuar më një vazhdueshmëri, duke ndjekur disa rregulla të thjeshta, si psh duke përdorur materiale të njëjta me të njëtin ndricim, duke rritur hapësirat për këmbësorët në hapësirat publike si dhe duke shtuar përdorime dhe funksione të ndryshme në hapësirat publike.Në kuadër të Investimeve të miratuara ne buxhetin e Bashkise Durres te vitit 2015, perkatesisht te vendimit nr. 303 Dt.01/12/2015 te Keshillit Bashkiak, Bashkia Durrës kërkon realizimin e projektit te zbatimit për: **Studim Projektim: “Projekt Zbatimi i sheshit publik para hyrjes se Portit “.**Objekti i këtij projekti është rikualifikimi i

hapesires urbane dhe arkitektonike te sheshit publik para hyrjes se porti, sic tregohet dhe ne fig. 1

Nga një shikim i parë i zonës vihet re një konfuzion i pergjithshem, si dhe mungesë organizimi dhe përcaktimi, i atyre zonave që lidhen me sistemin rrugor dhe që prezantojnë qytetit ne drejtimet e ndryshme të zhvillimit. Eshtë e qartë që kjo gjendje e degraduar nuk vjen nga infrastruktura, por nga konteksti në të cilin janë ndërfutur këto rrugë. Gjithashtu problematike shfaqet situata e trafikut te mjeteve ne nje nga kryqezimet e 2 prej rrugeve me te ngarkuara te qytetit te cilat jane ne te njejtin nivel. Kryqezimi ne fjale nuk rregullohet as me sinjalistike rrugore horizontale apo vertikale (psh semafor). Fluksi i kembësorëve nuk është i kontrolluar në asnjë mënyrë. Mungojne kalimet e këmbësorëve, trotuaret janë të pamjaftueshem, por mbi të gjitha mungon plotesisht harmonizimi i levizjes se kembesoreve dhe makinave.

E gjithë siperfaqja e sheshit eshte shume e aksidentuar. Ajo perdoret me se shumti si hapesire kalimi kryesisht per automjetet te cilat orientohen si drejt qendres se qytetit, hapesires se shetitores Taulantia apo rruges Egnatia (qe i risjell ne trafikun e qytetit). Gjithashtu mungojne shume elemente te peisazhit apo ato arkitektonike duke qene se jemi ne nje nga kryqezimet me te rendesishme te qytetit.

- Duke analizuar kete zone vihet re mungesa e nje hapesire sheshi si dhe ato te parkimit te automjeteve, ndaj kerkohet qe subjekt i trajtimit te jete hapesira me funksion shesh, prej rreth 12000 m<sup>2</sup>, sipas skices se bashkangjitur.
- Gjithashtu duke analizuar zonen per studim, hapesira e mundshme per te trajtuar si parkim nentokesor me nje siperfaqe rreth 4500-5000 m<sup>2</sup>, hapesire kjo e cila ndodhet ne qender te zones, sipas skices se bashkangjitur.
- Te shikohet mundesia e zgjidhjes se trafikut me nenkalim per kete nyje te sistemit rrugor.
- Te shikohet mundesia e projektimit te nje godine sherbimi 2 kat (ne zonen e evidentuar



ne fig.1), e cila te respektoje altimetrine e godines ekzistuese perpara hyrjes se portit si dhe vijen e ndertimit te kesaj godine.

**Fig. 1 KONTURI I ZONES PER RIKUALIFIKIMIN URBAN E ARKITEKTONIK.  
(SHESHI PARA HYRJES SE PORTIT )**

Parking i mbyllur nen tokesor	~ 4700 m <sup>2</sup>
Ambjente shërbimi	~ 1200 m <sup>2</sup>
Shesh urban	~ 12000 m <sup>2</sup>

**2. Te behet zgjidhja e nyjes se rrjetit rrugor me nen kalim, midis rruges "Anastas Durrsaku", Rruga "Egnatia", Rruga "Taulantia" dhe "Bulevardi Epidamn"**

Midis problemeve që shqetësojnë realitetin qytetar, janë ato të lidhura me lëvizshmërinë e trafikut. Keto kanë marrë në këto vitet e fundit një rol gjithnjë e më determinues. Një qarkullim urban fortësisht i përshpejtuar, jo vetëm që krijon shqetësime në përdoruesit për vetë rritjen e kohës mesatare të udhëtimit, që ato duhet të përshkruajnë për zhvendosjet e tyre, por shkakton edhe një ulje të ndjeshme të sigurisë së qarkullimit. Kjo sjell gjithashtu rritjen si të ndotjes atmosferike sikurse dhe atë akustike.

Midis shkaqeve kryesore të rritjes së dendësisë së trafikut, më e rëndësishmja është sigurisht rritja e fortë e kërkeses komplekse të transportit. Një rritje e tillë është e lidhur me një seri faktorësh të natyrave nga më të ndryshmet dhe shpesh të lidhura ngushtë edhe midis tyre.

Midis tyre më të rëndësishmit janë: shpërndarja në rritje e autovegurave, shpërndarja e vendodhjeve në territor për vetë rritjen e hapësirave urbane, ndryshimi i stileve të jetesës dhe shpesh një shërbim transporti publik me mangësi të caktuar.

Një drejtim racional dhe fleksibel i infrastrukturave dhe një programim i gjerë i rrjetit të trafikut, të mbështetura këto nga strategji të përshtatshme, infrastrukturë të mirë, janë konsideruar si instrumentat më efikasë për zgjidhjen e problemit të lëvizshmërisë urbane. Në rastet në të cilat nuk është e mundur rritja e kapacitetit të rrjetit nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave rrugore, analiza dhe projektimi i instrumentave të kontrollit të trafikut ka një rol themelor; një vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit të kryqëzimeve (semaforike ose jo), sepse, nëse ato janë mirë të projektuara, mund të paraqesin një instrument të vlefshëm për përmirësimin e këtij dendësimi.

Në fakt nyjet e rrjetit rrugor janë ato vende ku lindin konfliktet midis rrymave të ndryshme të trafikut, që sjellin si vonesa ashtu edhe aksidente, duke ulur nivelin e shërbimit dhe sigurinë e tyre. Prej këtu, zgjedhja e tipit të kryqëzimit (semaforike, me preçedence, tip rotondë, ose me nen kalim) behet shumë e rëndësishme për përmirësimin e parametrave të sipërpërmendur.

**3. Rishikimi i fasadave ne sheshin perpara hyrjes nr.1 te portit Durres.**

Ti kushtohet vëmendje e vecante harmonizimit te fasadave ne lidhje me objektet ne rrugen "Anastas Durrsaku", Rruga "Egnatia", Rruga "Taulantia" dhe "Bulevardi Epidamn". Objektet ne ate zone i perkasin nje arkitekture te viteve '30 .

**4. Fazat e punes dhe lista e dokumentacionit per tu paraqitur, per secilin sherbim te kerkuar.**

**4.a) Fazat e punes per secilin sherbim te kerkuar.**



## A. Sherbime qe i takojne studimeve te ndikimit ne mjedis:

Faza I-Faza V

### 1) Vleresimi fillestar mjedisor

(Qartesimi i kerkesave te projektit dhe percaktimi i qellimit te tij)

Pershkrimi i zones ne studim.

Mbledhja e dokumentacionit planifikues, ne dispozicion, specifikisht:

Studime dhe plane, vendore dhe rajonale;

Harta tematike, foto ajrore dhe te dhena te tjera.

Percaktimi i qellimit te projektit dhe nevojen e sherbimeve te specializuara shtese.

Inspektime ne terren.

Identifikimi ne parim i ndikimeve. Orientimi i nivelit te VNM-se dhe konsultimi me AKM/ARM-ne per vazhdimin e procedurave.

### 2) Gjendja e mjedisit (Identifikimi dhe vleresimi i bazes se te dhenave, vleresimi i gjendjes ekzistuese dhe permbledhja):

Permbledhja e legjislacionit perkates; Percaktimi i gjendjes ekzistuese; Mbledhja e te dhenave mbi bazen e dokumentacionit ekzistues dhe mbikeqyrjeve lokale ne terren, lidhur me:

Marredheniet e gjera ekologjike dhe vecanerisht ndikimet e faktoreve te peizazhit, si relievi, terreni, llojet e tokes dhe shkembinjve, siperfaqet ujore, ujerat nentokesore, klima lokale, flora, fauna dhe habitati i tyre;

Zonat e mbrojtura, peizazhet karakteristike dhe habitatet me vlera te mbrojtura;

> Perdorimet ekzistuese, demtimet dhe projektet e propozuara;

-Pamja dhe struktura e peizazhit;

-Asetet e materialeve dhe trashegimia kulturore.

- Vleresimi i situates ekzistuese;

- Vleresimi i qendrushmerise dhe ndjeshmerise se ekosistemit dhe peizazhit, ne perputhje me parimet e konservimit te natyres dhe menaxhimit te peizazhit.

### 3) Identifikimi i ndikimeve pozitive dhe negative (Analiza e konfliktit dhe alternativat):

> Identifikimi i pasojave te projektit, si rrjedhoje e ndikimit te tij ne mjedis.

> Lidhja e ndjeshmerise ekologjike dhe ajo e perdorimit te zones se studimit me ndikimin ne mjedis te projektit dhe pershkrimi i efekteve reciproke te faktoreve me te rendesishem.

> Karakterizimi i ndikimeve negative, sipas fazave te projektit

(Faza e ndertimit, faza e shfrytezimit dhe faza finale).

> Vleresimi i peshes se tyre, efekteve, qendrushmerise dhe mundesise per t'i zvogeluar apo evituar mbi bazen e karakteristikave, vlerave dhe ndjeshmerise se mjediseve te prekura.

> Paraqitja e permbledhjes ne forme narrative dhe ne har te.

Identifikimi i ndikimeve kryesore qe do te jene objekt i masave evituese.

Identifikimi i ndikimeve sociale. Pershkrim i ndikimeve te pa evitueshme. Krahasimi i alternativave.

Analiza e zhvillimit te 2 ose 3 alternativave me te mira duke i krahasuar nga pikepamja e vlerave dhe demtimeve/ pasojave mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Perzjedhja e alternatives me te pershtatshme.

### 4) Plani i menaxhimit mjedisor (Versioni paraprak i studimit)

Zhvillimi i zgjidhjes baze per elementet thelbeshore te projektit dhe paraqitja e tyre ne forme narrative dhe harte se bashku me alternativat.

Identifikimi, vleresimi dhe paraqitja per cdo zgjidhje thelbesisht te ndryshme, duke patur parasysh vendimin per te shmangur ndikimet negative dhe/ ose per te favorizuar ato pozitive ndaj ekosistemit.

Riskun ekologjik ndaj ekosistemit; Demtimin e pamjes se peizazhit; Ndikimin tek njerezve, tek perdorimi i strukturave, tek te mirat materiale dhe tek trashegimia kulturore.

Pershkrimi i tendencave te zhvillimit ne zonen e analizes, pa nderhyrjen e projektit te planifikuar (parashikimi prognozes status quo).

Identifikimi dhe paraqitja e demtimeve, per te cilat eshte parashikuar qe nuk mund te behen permiresime.

Seleksionimi krahasues per alternativat thelbesisht te ndryshme.

Aprovimi i draftit paraprak te studimit nga klienti.

### 5) Raporti final (Versioni final i studimit)

Prezantimi i studimit te ndikimit ne mjedis ne tekstin e pershkruar si dhe ne nje harte pergjithesisht ne shkalle 1:5'000, duke perfshire nje raport jo teknik.

## B. SHËRBIME QË I TAKOJNË NËNTOKËS DHE PUNIMEVE NË THEMELE:

### Faza I-Faza III

1. Sherbimet, qe lidhen me kapacitetin mbajtes te tokes, punime tokesore dhe themele, jane per te regjistruar reagimet midis struktures se tokes dhe ndertesave, si dhe mjedisin e saj, per te percaktuar parametrat kryesore te struktures se tokes te nevojshme per llogaritje.

1.1 Sherbimet qe lidhen me kapacitetin mbajtes te tokes, punime tokesore dhe themele, ne menyre te vecante mund te perfshijne:

1.2. Vleresimi i nentokes dhe puna konsultuese per pozicionimin e themelit, si nje baze per dimensionimin e tyre si mbajtes ngarkesash ne strukturen inxhinierike, per aq sa keto sherbime nuk mund te kryhen me aplikimin e tabelave ose informacioneve te tjera, te perfshira ne rregulloret e ndertimit ne fuqi;

1.3. Mbikeqyrja dhe vleresimi pergatitor per vendin e punes;

1.4. Kryerja e analizave laboratorike dhe e testeve ne terren; Keshillimi per sigurimin e strukturave ngjitur;

1.5. Dhenia e zgjidhjeve, drenazhimi dhe llogaritje te tjera statike te tokes.

1.6. Studimet qe perfshijne tensionet dinamike ne llogaritjet e ndertesave apo themeleve;

1.7. Keshillimi mbi masat e ndertimit ne shtresat e ngurta shkembore; Miratirni dhe pranimi i germimeve dhe derdhjeve;

1.8. Vleresimi i pergjithshem i kapacitetit mbajtes te struktures se tokes dhe mundesite per themele, qe nuk lidhen me nje ndertese te vecante ose vepra inxhinierike.

1.9. Vleresimi i nentokes dhe konsulencat per punimet ne themeleve.

## C. SHËRBIMET E RILEVIMIT TOPOGRAFIK:

### Faza I-Faza VI

1) Faza I: Analiza e detyres se projektimit dhe percaktimi i hazes se projektit  
Gjetja dhe marrja e informacionit dhe dokumentacionit ne vendndodhjen ku eshte planifikuar objekti. Gjetja e dokumentacionit te rilevimit. Inspektimi ne vend. Vendosja e qellimit te projektit e lidhur relativisht me kerkesat e saktetise dhe shkallen e veshtiresise.

2) Faza II: Grupimi i pikave te palevizshme gjeodezike Identifikimi dhe shenimi i pikave per pozicionim dhe rilevim. Hartimi i perskrimeve per pikat e palevizshme dhe shoqeruar me skemat perkatese. Kryerja e matjeve per te percaktuar pikat fikse dhe ato te kontrollit. Analizimi i matjeve dhe hartimi i rjetit mbeshtetes gjeodezik dhe ate te rilevimit.

3) Faza III: Planet e pozicionimit dhe te rilevimit

Studimet topografike/ morfologjike (tokesore/ ajrore) duke perfshire regjistrimet e pikave kufizuese. Analiza e matjeve/ fotografive ajrore. Hartimi i planeve qe paraqesin situaten e objektit duke perfshire zonen e mbuluar nga projekti dhe te dhenat kadastrale. Paraqitja erilevimeve ne format te pikezuar, matrica ose ne forme vizash konturuese. Hartimi i nje model terreni te dixhitalizuar. Prezantim grafik i kanaleve, rjetit elektrik, kabllot dhe strukturat nentokesore sipas dokumentacionit ekzistues. Perfshi rregullat zyrtare bashkekohore. Te gjitha matjet te jene ne format dixhital.

4) Faza IV: Vizatime te piketave

Llogaritja e matjeve gjeometrike bazuar ne projekt dhe perpilimi i dokumentacionit dhe piketimit - Piketimi per projektin

Percaktimi dhe transferimi i vijes referenciale per objekte lineare ne kantier.

Percaktimi dhe transferimi i gjeometrise se projektit ne kantier per procedurat e orientimit dhe te vendosjes se kondicioneve urbane.

5) Faza V: Projekti i zbatimit: Piketat per qellime planifikimi

Transferimi ne terren i vijes referenciale per objektet lineare(p.sh. kufiri i ndertimit)

Transferimi i gjurmes se projektit ne terren per kontrollin e aktit te piketimit te objektit nga organet kompetente.

6) Faza VI: Seksionet gjellogjike

Identifikimi dhe paraqitja e profileve gjatesore dhe terthore nga matjet tokesore dhe fotogrametrike.

## D. PLANIFIKIMI I NDËRTESAVE DHE NDARJET FUNKSIONALE TË BRENDSHME

### Faza I-Faza VI

#### 1. Analiza e detyres se projektimit dhe percaktimi i fazes se projektit

Inventarizim fillestar; Analizimi ne vend; Planifikimi operacional;

Prodhimi i nje grafiku punimesh per perdorimin e hapesires;

Pergatitja e nje grafiku punimesh per funksionalitetin; Kontroll per ndikimin mjedisor;

Kontroll per pajtueshmerine mjedisore.

#### 2. Projekt idea paraprake

Shqyrtim i zgjidhjeve alternative qe do t'i nenshtrohen kerkesave rrenjesisht te ndryshme;

Dokumenta shtese paraprake te projektimit per te pasqyruar kerkesat e vecanta; Pergatitja e nje plani financimi;

Pergatitja e analizes kosto-perfitim per fazen e ndertimit dhe ato operative;

Ndihma me prokurimin e kredive;

Kryerja e aplikimit paraprak (aplikimi per lejet e ndertimit); Pergatitja e grafikutme afatet kohore dhe planin e veprimit;

Pergatitja e prezantimeve me teknika bashkekohore specifike duke perfshire makete, vizatime perspektive, templeta, etj;

Dokumente shtese paraprake te projektimit lidhur me masat e vecanta te ndermarra per racionalizimin e ndertimeve dhe perberesve te vecante, te cilat shkojne pertej fushes normale te sherbimeve te detyrave te projektimit, ne menyre qe te zvogelohet niveli i konsumit te energjise dhe cilrimet e substancave te demshme dhe karbonit, si dhe per te shfrytezuar burimet e ripertesishme te energjise ne konsultim me specialistet e tjere te perfshire ne procesin e planifikimit. Fusha e zakonshme e veprimtarise per masat e kursimit te energjise eshte arritur nga permbushja e kerkesave te perfshira ne dispozitat ligjore dhe standardet teknike te pranuar.

### **3. Projekt - ideja perfundimtare**

#### **4. Projekti per miratimin e lejes se nderimit**

Ndihma me marrjen e pelqimit te pronareve te pronave ngjitur; Pergatitja e dokumentacionit per procedural e vecanta te aprovimit;

Ofrimi i mbeshtetjes teknike dhe organizative per klientin gjate procedurave te apelit, veprimeve juridike/ gjyqesore e te tjera te kesaj natyre;

Rishikim i dokumentacionit ne rrethana qe ndodhin jashte kontrollit te ofruesit.

#### **5. Projekti i zbatimit**

Pergatitja e nje pershkrimi te detajuar te projektit ne formen e nje "libri te nderimit", per te sherbyer si baze per specifikimet e projektit dhe grafikut te punimeve<sup>1</sup>;

Pergatitja e nje pershkrimi te detajuar te projektit ne formen e nje libri te shfrytezimit te hapesires, per te sherbyer si baze per specifikimet e projektit dhe grafikut te punimeve;

Kontrolli i planeve te zbatimit te pergatitura nga kontraktuesi i nderimit, bazuar ne specifikimet e projektit dhe grafikun e punimeve per perputhje me planet perfundimtare;

Zhvillimi i librezes se masave;

Kontrolli dhe pranimi i vizatimeve te prodhuara nga specialistet e pales se trete te paperfshire ne planifikimin e projektit per perputhje me vizatimet e zbatimit (vizatime nga ofruesit, vizatimet e instalimeve te ndryshme dhe te themeleve dhe vizatimet e ofruara nga ofruesit e makinerive) ne rastin kur keto sherbime kane te bejne me sisteme qe nuk mbulohen ne kostot e llogaritshme.

#### **6. Preventivi perfundimtar**

Pergatitja e preventivit dhe programit te punes duke iu referuar librit te nderimit<sup>1</sup> [dokumentacioni baze per menaxhimin e projektit (project management)] dhe librit te hapesirave<sup>2</sup> [libri baze i ndarjes j emerimit/ perkufizimit te hapesirave dhe siperfaqeve te projektit];

Pergatitja e specifikimeve alternative te projektit per zonat e sherbimeve te vecanta;

Pergatitja e permbledhjes se kostove krahasuese, duke vleresuar kontributet e bera nga specialiste te tjere te perfshire ne planifikimin e projektit.

## **F. PLANIFIKIMI I SISTEMEVE TEKNIKE**

### **Faza I-Faza VI**

1. Analiza e detyres se projektimit dhe percaktimi i bazes se projektit

Analiza e sistemeve (sqarime per sistemet e mundslune per sa i perket perfitimeve, shpenzimeve, efektivitetit te kostove, fizibilitetit dhe ndikimit ne mjedis);

Hedhja e te dhenave, analiza dhe proceseve te duhura per kursimin e energjise dhe metodave te pershtatshmerise mjedisore.

2. Projekt-idea paraprake

Kryerja e provave dhe e testeve te kontrollit;;

Shqyrtimii rezultateve te ndertimit dhe sistemit te duhur, per sa i perket konsumit te energjise dhe lirimit te ndotesve (p.sh. SOzNOx);

Zhvillimi i strategjive per permiresimin e konceptit energjetik.

3. Projekt-idea perfundimtare

Perpunimi i te dhenave nga pala e trete (p.sh. transmetimin e drites, transmetimin e fuqise termike, etj.);

Studimi i hollesishem i effiencas ekonomike; Krahasimi i hollesishem per lirimin e ndotesve;

Perllogaritja e kostove operacionale; Perllogaritja e ciritimit te ndotesve;

Pergatitja e pjeseve teknike ne katalogujlibrit te hapësirave, si pjese e preventivit dhe planit te punes se projektuesit.

4. Projekti per miratimin e lejes se ndertimit

5. Projekti i zbatimit

Kontroll dhe pranim i vizatimeve duke filluar nga ato te formave te betonit e deri ne ato te strukturave mba jtese dhe pershtatja e vizatimeve nga kontraktoret, apo of ruesit me vizatimet e tyre dhe projektin ne teresi;

Pergatitja e vizatimeve per lidhjet e makinerive dhe fadromave nga furnitoret e ndryshem;

Pergatitja e diagramave te lidhjeve elektrike.

6. Preventivi perfundimtar.

## G. PLANIFIKIMI I STRUKTURAVE TË TRANSPORTIT

1. Analiza e detyres se projektimit dhe percaktimi i bazes se projektit

Perzgjedhja dhe shqyrtimi i projekteve te ngjashme; Identifikimi i ngarkesave te vecanta te papercaktuara ne norma.

2. Projekt idea paraprake

Pergatitja e analizes se kosto-perfitimit;

Pergatitja e dokumentacionit topografik dhe hidrologjik; Llogaritja e sakte e elementeve te ve ante strukture,

Koordinimi dhe paraqitja e pajisjeve dhe percjellesve ne rastin e ngarkesave levizese;

3. Projekt idea perfundimtare

Sigurimi i ekstrakteve kadastrale nga regjistrat kadastrale dhe dokumente te tjera zyrtare;

Perditesimi i analizes kosto-perfitim; Llogaritja e sinjaleve teknike;

Bashkeveprimi ne marreveshje administrative.

4. Projekti per miratimin e lejes se ndertimit Bashkeveprimi ne marrjen e pelqimit nga palet e perfshira; Pergatitja e dokumenteve per punimet e themeleve.

5. Projekti i zbatimit

Pergatitja e planeve te nderthurura dhe proceseve;

7. Preventivi perfundimtar.

## 5. LISTA E PROJEKTEVE QE DUHEN PARAQITUR

1. Relacioni i pergjithshem i projektit.
2. Projekti arkitektonik:
  - Planimetri
  - Pamje
  - Prerje
  - Pamje 3D te projektit
  - Fotomontazhe.
  - Plani i sistemimeve me kuota altimetrike.
  - Plani i gjelberimit.
  - Plani i kullimit te ujrave me detajet perkatese (*kuneta, pusea inspektimi, etj*)
  - Detaje Zbatimi (*ne shkalle te lexueshme, sh 1:10; 1:20; 1:50*)
  - Relacionet dhe specifikimet perkatese.

*Format A4*

*Format A2, A1, A0*

Shenim Teknik : Te gjitha Vizatimet Arkitektonike te jene ne shkallen 1 : 100

3. Projekt zbatimi konstruktiv dhe i rrjetit te infrastrukturës inxhinierike: *Format A2, A1, A0*
  - Planimetri te projektit konstruktiv dhe te infrastrukturës elektrike, kanalizime kub, sinjalistikë horizontale dhe vertikale
  - Profile gjatësor
  - Profile tërthor
  - Detaje Zbatimi
  - Prerje
  - Relacionet dhe specifikimet përkatëse

Shenim Teknik : Te gjitha Vizatimet e projektit konstruktiv dhe rrjetit te infrastrukturës te jene ne shkallen 1 : 100

4. Projekti i ndricimit.
  - Planimetri e pergjithshme sh 1:100
  - Detaje ndricimi (*ne shkalle te lexueshme, sh 1:10; 1:20; 1:50*)

5. Projekt zbatimi i rrjetit rrugor te propozuar se bashku me sheshet, sheshet e parkimit, te gjelberimit. Me relacionet dhe specifikimet perkatese
  - Planimetri te rrjetit rrugor
  - Profile gjatësor
  - Profile tërthor
  - Detaje Zbatimi
  - Prerje
  - Relacionet dhe specifikimet përkatëse

Shenim Teknik : Te gjitha Vizatimet e projektit konstruktiv dhe rrjetit te infrastrukturës te jene ne shkallen 1 : 100

*Format A2, A1, A0*

6. Preventivi i punimeve dhe analiza e tyre, sipas manualit të çmimeve të vitit 2015 të miratuar nga Ministria, i shoqeruar me specifikimet teknike perkatese.

Format A4

7. Grafiku i punimeve per zbatimin e vepres.

8. Studimi gjeologjik.

9. Fragment i relievit topo – gjeodezik ne Sh.1:500, Sh.1:1000.

- Paraqitja e profileve gjatesore dhe terthore nga matjet tokesore dhe fotogrametrike.

10. Vlerësim të ndikimit në mjedis.

Shenim:

- Projekti do te hartohet dhe paraqitet ne 5 kopje, te printuara sipas formateve te specifikuara me siper dhe informacioni tërësisht i dixhitalizuar ne 5 kopje format .dwg dhe .pdf ( CD apo DVD )
- Kopja elektronike e projektit eshte pjese perberese e dokumentacionit teknik te dorezuar.
- Dorezimi do te behet prane Bashkise Durres
- Depozitimi i tij do te behet prane Sekretarise Teknike te Drejtorise te Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit te Bashkise Durres.

Bashkangjitur: Kontrata e bashkëpunimit+prokura e posaçme 3 faqe, Metodologjia 62 faqe, struktura e propozimit ekonomik+oferta ekonomike+oferta ekonomike e detajuar 3 faqe.

Autoriteti Kontraktor  
Bashkia Durres

Emri dhe firma e Përfaqësuesit  
Vangjush DAKO  
Kryetar i Bashkise

Vula:



Kontraktuesi  
ERALD- G + ARKONSTUDIO

*Gezim Islami*  
Emri dhe firma e Përfaqësuesve

ERALD- G  
Gezim ISLAMI



ARKONSTUDIO

Krenar DILA  
*Krenar Dila*

Administrator te shoqërisë  
Vulat:

